

AMERICAN HOSPITAL SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE të përgatitura sipas

STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019



Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur

Pasqyrat financiare

Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Përmbledhje e politikave kontabël.....	5
3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël	17
4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara	20
5. Standarde dhe interpretime të reja	22
6. Aktive afatgjata materiale.....	23
7. Aktive afatgjata të mbajtura për investim.....	24
8. Aktive me të drejtë përdorimi.....	24
9. Aktive afatgjata jo materiale.....	25
10. Investime në filiale	26
11. Hua të dhëna	26
12. Inventari.....	26
13. Aktive të tjera	26
14. Klientë dhe llogari të tjera të arkëtueshme	27
15. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre.....	28
16. Huamarrjet.....	29
17. Furnitorë dhe llogari të tjera të pagueshme	30
18. Provizione.....	30
19. Kapitali Aksionar.....	31
20. Të ardhurat.....	31
21. Të ardhura të tjera.....	32
22. Kosto e materialeve dhe mallrave.....	32
23. Shpenzime personeli.....	32
24. Shpenzime të tjera operative.....	33
25. Shpenzime financiare neto.....	33
26. Tatimi mbi fitimin	34
27. Menaxhimi i rrezikut financiar	36
28. Kushtëzime dhe angazhime	40
29. Palët e lidhura	40
30. Ngjarje pas datës së raportimit	40
31. Politikat kontabël përpara datës 1 janar 2019.....	41

Shtojcat

Pasqyra e pozicionit financiar

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Pasqyra e flukseve monetare

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerit të American Hospital SH.A.:

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të American Hospital SH.A. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare individuale të American Hospital SH.A. përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera të cilat pritet të na vendosen në dispozicion pas datës së raportit tonë përfshijnë Raportin e ecurisë së veprimtarisë (por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit).

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F:+355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Kur ne të lexojmë informacionet e tjera, nëse ne arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar t'ia komunikojmë këto çështje personave të ngarkuar me qeverisje.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.



- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.

9 qershor 2020

Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor

Jonid Lamllari

American Hospital SH.A.


Pasqyra e pozicionit financiar

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktivitet			
Aktive afatgjata materiale	6	2,339,146	2,320,689
Aktive afatgjata të mbajtura për investim	7	6,817	-
Aktive me të drejtë përdorimi	8	631,721	-
Aktive afatgjata jo materiale	9	14,146	12,574
Investime në filiale	10	421,745	421,745
Hua të dhëna	11	828,037	839,256
Totali i aktiveve afatgjata		4,241,612	3,594,264
Inventari	12	260,217	291,362
Aktive të tjera	13	83,260	107,329
Tatim fitimi i parapaguar		26,563	66,552
Klientë dhe llogari të tjera të arkëtueshme	14	236,812	201,229
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	15	13,847	24,857
Totali i aktiveve afatshkurtra		620,699	691,329
Totali i aktiveve		4,862,311	4,285,593
Kapitali			
Kapitali aksionar	19	2,925,402	2,930,952
Rezerva rivlerësimi		1,869	-
Humbje të mbartura		(1,193,191)	(1,137,860)
Totali i kapitalit		1,734,080	1,793,092
Detyrime afatgjata			
Huamarrjet	16	340,472	486,321
Detyrime të qirasë	8	642,243	-
Furnitorë dhe llogari të tjera të pagueshme	17	156,892	157,585
Provizione	18	143,486	153,335
Totali i detyrimeve afatgjata		1,283,093	797,241
Detyrime afatshkurtra			
Huamarrjet	16	614,705	539,828
Detyrime të qirasë	8	2,167	-
Furnitorë dhe llogari të tjera të pagueshme	17	1,097,481	1,013,817
Detyrime të tjera	18	130,785	141,615
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,845,138	1,695,260
Totali i detyrimeve		3,128,231	2,492,501
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		4,862,311	4,285,593

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli Drejtues më datë 5 qershor 2020 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

Dr. Klodian Allajbeu
Drejtor Ekzekutiv & Administrator



Znj. Osvelda Qafa
Drejtoreshë Finance

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

American Hospital SH.A.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

	Shënime	2019	2018
Të ardhurat	20	5,322,928	4,885,234
Të ardhura të tjera	21	82,916	25,156
Kosto e materialeve dhe mallrave	22	(1,623,955)	(1,495,300)
Shpenzime personeli	23	(1,328,694)	(1,352,603)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	6,7,8,9	(385,564)	(276,862)
Humbje neto nga zhvlerësimi i aktiveve financiare		2,228	(3,800)
Humbje neto nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata	24	(19,239)	(20,436)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata	24	(26,460)	-
Shpenzime të tjera operative	24	(2,038,477)	(1,964,869)
Fitim/(Humbje) operative		(14,317)	(203,480)
Të ardhura financiare	25	31,699	22,672
Shpenzimet financiare	25	(62,105)	(19,361)
Fitimi nga kurset e këmbimit, neto	25	22,679	34,178
Humbje e vitit, para tatimit		(22,044)	(165,991)
Shpenzime për tatim fitimin	26	(33,287)	(1,791)
Humbje e vitit		(55,331)	(167,782)
<i>Zëra të cilët nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje:</i>			
Rivlerësimi i aktiveve afatgjata		1,869	-
Tatimi mbi fitimin i njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatim fitimi		1,869	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për vitin		(53,462)	(167,782)

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

American Hospital SH.A.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva rivlerësimi	Humbje e mbartur	Totali
Gjëndja më 31 dhjetor 2017	2,930,952	-	(959,578)	1,971,374
Përshtatja me standardet e reja të raportimit	-	-	(10,500)	(10,500)
Gjëndja e rregulluar më 1 janar 2018	2,930,952	-	(970,078)	1,960,874
Totali humbjes gjithëpërfshirëse për vitin				
Humbja e vitit	-	-	(167,782)	(167,782)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatim fitimi	-	-	-	-
Totali humbjes gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(167,782)	(167,782)
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	2,930,952	-	(1,137,860)	1,793,092
Përshtatja me standardet e reja të raportimit	-	-	-	-
Gjëndja më 1 janar 2019				
Humbja e vitit	-	-	(55,331)	(55,331)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatim fitimi	-	-	-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(55,331)	(55,331)
Rënie në kapital	(5,550)	-	-	(5,550)
Rivlerësimi i aktiveve afatgjata	-	1,869	-	1,869
Gjëndja më 31 dhjetor 2019	2,925,402	1,869	(1,193,191)	1,734,080

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

American Hospital SH.A.

Pasqyra e flukseve monetare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

	Shënime	2019	2018
Flukset monetare nga aktiviteti operativ			
Humbja para tatimit		(22,044)	(165,991)
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7,8,9	385,564	276,862
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata		26,460	-
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata		19,239	20,436
Zhvlerësimi neto i aktiveve financiare	14	(2,228)	3,800
Shpenzim i tatimit mbi fitim		-	-
Kompensime tatimore		6,702	-
Shpenzime neto financiare	25	30,406	(3,311)
		444,099	131,796
<i>Ndryshime në aktive dhe detyrimet operative:</i>			
(Rritje)/rënie në inventar	12	31,145	(32,410)
(Rritje)/rënie në të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	14	(33,355)	(48,294)
(Rritje)/rënie në aktive të tjera	13	24,069	6,914
Rritje në llogari të pagueshme tregtare	17	144,619	376,878
Ndryshime në provizione	18	(9,849)	46,631
Rritje në detyrime të tjera		(10,830)	25,477
Tatimi mbi fitim i paguar		-	(19,813)
Mjete monetare neto nga aktiviteti operativ		589,898	487,179
Flukset monetare nga aktiviteti investues			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(442,768)	(456,896)
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	9	(5,850)	(2,837)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		9,257	784
Blerje e filialeve, neto		-	(133,071)
Interes i arkëtuar		31,699	22,672
Hua dhënë palëve të lidhura		-	(524,829)
Mjete monetare neto nga aktiviteti investues		(407,662)	(1,094,177)
Flukset monetare nga aktiviteti financues			
Rënie në kapital	19	(5,550)	-
Interesi i paguar	25	(29,666)	(19,361)
Shlyerje të huave	16	(65,346)	-
Hyrje nga huatë		-	624,674
Pagesa të detyrimeve të qirasë financiare	16	(88,506)	-
Mjete monetare neto nga aktiviteti financues		(189,068)	605,313
Rënie neto e mjeteve monetare		(6,832)	(1,685)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		24,857	26,542
Efektet e kursit të këmbimit		(4,178)	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor	15	13,847	24,857

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Pasqyrat financiare individuale të American Hospital sh.a. ("Shoqëria") janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019.

American Hospital sh.a. është një shoqëri që ushtron veprimtarinë e saj në Tiranë, Shqipëri dhe zotërohet plotësisht nga Balkan Alliance Healthcare B.V. ("Grupi") e bazuar në Hollandë. Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Nr. 35179, datë 10 mars 2006. Shoqëria është një filial jo i drejtpërdrejtë i Southeast Europe Equity Fund II (B), L.P., i cili drejtohet nga Small Enterprise Assistance Funds ("SEAF") SEE Management LLC si drejtues i investimeve. Asnjë nga pjesëmarrësit në Fondin e mësipërm nuk ka kontroll mbi të, pasi pjesëmarrjet nuk kalojnë 25% të totalit.

Shoqëria është licënuar më 30 janar 2007 dhe rikonfirmuar më 19 shkurt 2008 për të ushtruar veprimtarinë e tij me spitale dhe qendra mjekësore në Shqipëri, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 238, datë 13 prill 2003, "Mbi licënsimin e veprimtarisë private në industrinë e kujdesit për shëndetin". Me çeljen e Qendrës Kombëtare të Licënsimit në Shqipëri, si i vetmi autoritet licënsues në vend, Shoqëria është licënuar nga ky autoritet më 29 shtator 2009. Aktiviteti kryesor i Shoqërisë përbëhet nga sigurimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë pacientët ambulator, pacientët e shtruar, dializë, imazh të avancuar diagnostikues dhe shërbime laboratorike. Në fund të vitit 2018, Shoqëria operoi nëpërmjet tre spitale edhe dy poliklinika në Tiranë, një qendër laboratorike qendrore në Tiranë dhe dy qendra mjekësore në Fier dhe Durrës. Adresa e regjistruar e Shoqërisë është Rruga Sabaudin Gabrani nr. 2, Tirana, Albania.

Shoqëria zotëron dy filiale: American Hospital Kosova sh.p.k dhe International Hospital sh.a. Të dyja shoqëritë ushtrojnë veprimtari në lidhje me shërbimet e kujdesit shëndetësor respektivisht në Kosovë dhe Shqipëri. Pasqyrat financiare të filialeve nuk janë të konsoliduara në këto pasqyrat financiare individuale.

2. Përmbledhje e politikave kontabël

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me SNRF, në bazë të kostos historike. Politikat kryesore kontabël të aplikuara në këto pasqyra financiare janë paraqitur si më poshtë. Përveç ndryshimeve në politikat kontabël që vijnë nga përshtatja e SNRF 9 dhe SNRF 15, efektive nga 1 janar 2018, këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur shprehet ndryshe. Politikat kryesore kontabël për instrumentet financiare dhe njohjen e të ardhurave të aplikuara deri në 31 dhjetor 2018 janë paraqitur në shënimin 31.

Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare individuale për t'i raportuar autoriteteve tatimore në Shqipëri.

Shoqëria gjithashtu përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për shoqërinë dhe filiale të saj ('Grupi'). Në pasqyrat financiare të konsoliduara, filiale të konsoliduara plotësisht. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë në dispozicion dhe mund të merren nga Shoqëria. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare individuale duhet t'i lexojnë ato së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit në dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 me qëllim që të marrin informacion të plotë mbi pozicionin financiar, rezultatet e operacioneve dhe ndryshimet në pozicionin financiar të grupit si një e tërë.

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të kërkon përdorimin e disa vlerësimeve dhe gjykimeve kontabël të veçanta. Kërkohej gjithashtu që menaxhimi të ushtrojë gjykimin e tij gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të grupit. Rastet kur kërkohej një nivel më i lartë gjykimi apo kompleksiteti, ose kur supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, siç shpjegohen në shënimin 3.

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Parimi i vijmësisë

Drejtimi i Shoqërisë ka përgatitur këto pasqyra financiare individuale mbi bazën e parimit të vijmësisë. Në Shënimin shpjegues 3, janë paraqitur analizat dhe pritshmëritë e Drejtimit.

Monedha funksionale dhe paraqitja

Këto pasqyra financiare individuale janë paraqitur në Lekë ("Lek" ose "Lekë"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë, monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon Shoqëria. Të gjitha informacionet financiare të paraqitura në Lekë janë rrumbullakosur në shumën më të afërt, përveçse kur përcaktohet ndryshe.

Krahas paraqitjes së pasqyrave financiare individuale në Lekë, është përgatitur informacioni plotësues në Euro për lehtësimin e përdoruesve të pasqyrave financiare. Informacioni plotësues nuk është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale të përgatitura në përputhje me SNRF. Informacioni plotësues është paraqitur në Euro duke përdorur kurset e këmbimit valutor Euro / Lekë në vijim. Kapitali dhe fitimi i pashpërndarë janë konvertuar me kursin e këmbimit në datat e transaksionit.

ALL	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe e flukseve të mjeteve monetare		Pasqyra e pozicionit financiar	
	2019	2018	2019	2018
EUR	123.01	127.58	121.77	123.42

Investime në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta

Investimet në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta maten me kosto minus humbjen nga zhvlerësimi. Kostot e transaksionit kapitalizohen si pjesë e kostos së investimit. Kostot e transaksionit janë kostot që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së investimit me një tarifë profesionale për shërbimet ligjore, taksat e transferimit dhe shpenzimet e tjera të blerjes.

Kostoja fillestare e investimeve përfshin gjithashtu edhe konsideratën kontigjente. Rivlerësimi i mëposhëm i shumës së kushtëzuar të klasifikuar si pasiv financiar rregullohet kundrejt kostove të investimit.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se shuma bartëse e një investimi mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse shuma e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë e vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlera e tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme.

Vlera kontabël e një investimi është çregjistruar në shitje. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit të shitjes dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël të investimit njihet si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta vlen edhe nëse rezultati i nxjerrjes nga përdorimi është një hap poshtë nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose një pjesëmarrje të matur me kosto.

Transaksionet në monedhë të huaj

Aktivitetet dhe detyrimet monetare konvertohen në monedhën funksionale të Shoqërisë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës Qendrore të Shqipërisë ("BSH") në fundin përkatës të periudhës raportuese. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga transaksionet dhe nga konvertimi i mjeteve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të Kompanisë në kurset zyrtare të këmbimit të BSH-së në fund të vitit, njihen në fitim ose humbje si fitim (humbje), neto. Fitimet dhe humbjet në valutë të huaj që lidhen me huamarrjet dhe paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse brenda 'Të ardhurave ose kostove financiare'. Të gjitha fitimet dhe humbjet e tjera në valutë të huaj janë paraqitur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse brenda 'Fitimeve / humbjeve të tjera neto'. Konvertimi në fund të vitit nuk aplikohet për zërat jo monetarë që maten me kosto historike. Zërat jo monetarë të matura me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj, duke përfshirë investimet e kapitalit, janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo monetarë të matura me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes së vlerës së drejtë.

Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja. Aktivet afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto e një njësie të aktiveve afatgjata materiale është çmimi i tij ekuivalent në para në datën e njohjes. Nëse pagesa është e shtyrë përtej kushteve normale të kreditimit, diferenca midis çmimit ekuivalent në para dhe pagesës totale njihet si interes gjatë periudhës së kreditimit. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërsëdrejti me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria, përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërsëdrejti me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimin e tokës në gjendjen origjinale, si dhe kostot e kapitalizuara të huamarjes.

Toka dhe ndërtesat i nënshtrohen rivlerësimit me qëllimin për të siguruar që vlera kontabël nuk ndryshon materialisht nga sa do të përcaktohej vlera duke përdorur vlerën e drejtë në fund të periudhës së raportimit. Rritjet në vlerën kontabël që vijnë nga rivlerësimi i kreditohen të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe rritin rezervën e rivlerësimit në kapital. Zvogëlimet që netojnë rritjet e mëparshme të të njëjtit aktiv, njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe ulin tepicën e rivlerësimit të njohur më parë në kapital; të gjitha uljet e tjera ngarkohen në fitim ose humbje për vitin. Rezerva e rivlerësimit për tokën dhe ndërtesat e përfshirë në kapitalin neto transferohet drejtpërdrejt në fitimet e mbartura pasi aktivi përdoret nga Shoqëria; së fundmi, shumata e tepicës së realizuar është diferenca midis zhvlerësimit bazuar në vlerën e rivlerësuar kontabël të aktivit dhe zhvlerësimit bazuar në koston fillestare të aktivit.

Nëse nuk ka prova të bazuara në treg për vlerën e drejtë, vlera e drejtë vlerësohet duke përdorur qasjen e kostos dhe të ardhurave.

Drejtimi ka azhornuar vlerën kontabël të tokës dhe ndërtesave, të matura në përputhje me modelin e rivlerësimit, në fund të periudhës raportuese duke përdorur prova të bazuara në treg. Drejtimi ka azhornuar vlerën kontabël të tokës dhe ndërtesave të matura në përputhje me modelin e rivlerësimit në fund të periudhës raportuese duke përdorur metodën e kostos për pjesën e ndërtesës dhe vlerën e tregut për tokën.

Shpenzimet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të aktiveve ose njihen si një aktiv i veçantë, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me artikullin do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostoja e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtjes së përditshme njihet si shpenzim kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve kryesore apo përbërëse të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohet ndërsa pjesa e zëvendësuar del nga përdorimi aktiv.

Në çdo fund të çdo date të raportimit, Drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të pronës, impiantëve dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, Drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e drejtë e një aktivi minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi i njohur për një aktiv në vitet paraqarake shfuqizohet ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një njësie të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur dhe njihen në fitimin ose humbjen e vitit.

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Programet (software) të blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisjeje.

Kur pjesët e pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të veçantë (përbërës kryesorë) të pronës dhe pajisjeve.

Zhvlerësimi. Zhvlerësimi llogaritet mbi vlerën totale, e cila është kosto e një aktivi ose çdo vlerë tjetër që e zëvendëson koston, minus vlerën e mbetur.

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metoden e zhvlerësimit mbi vlerën e mbetur, përveç zhvlerësimit të ndërtesave i cili njihet duke përdorur metodën e zhvlerësimit linear, për një periudhë deri në 40 vjet. Normat vjetore të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Pajisje dhe instrumente	20%
Mjete transporti	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Pajisje IT	25%

Përmirësimet e qiramarrjes zhvlerësohen brenda periudhës prej 5 deri në 20 vite, e cila është periudha më e shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetëgjatësisë së tyre të dobishme. Toka dhe aktivet në proces nuk zhvlerësohen. Në përcaktimin e jetëgjatësisë së ndërtesave dhe pajisjeve, Shoqëria merr në konsideratë aspektin teknologjik të paisjeve dhe faktin që Shoqëria operon në një industri ku përparimet teknologjike janë të shpejta dhe zhvillohen vazhdimisht.

Jetëgjatësitë e dobishme, metodat e zhvlerësimit, dhe vlerat e mbetura nëse janë të rëndësishme, shqyrtohen në çdo datë raportimi dhe rishikohen nëse është e nevojshme.

Aktivitet afatgjata jo materiale

Aktivitet afatgjata jo materiale të blera nga Shoqëria janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet vijuese për aktivitet e patrupëzuara, kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike materiale në aktivin përkatës, me të cilin ato lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në metodën e amortizimit zbritës me norma vjetore të cilat variojnë midis 25% dhe 33%.

Aktive me të drejtë përdorimi. Shoqëria mer me qira ambjente të ndryshme dhe pajisje. Kontratat mund të përfshijnë elemente që lidhen drejtpërdrejt me qira ose jo. Shoqëria ka shpërndarë koston e elementëve që lidhen me qiranë ose jo bazuar në çmimet e secilit element.

Aktivitet me të drejtë përdorimi maten fillimisht në bazë të vlerës aktuale.

Aktivitet me të drejtë përdorimi maten bazuar në kosto të përbërë nga elementët e mëposhtëm:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë
- çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, minus çdo stimul qiraje të marrë
- çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi
- kostot për të kthyer aktivin në gjendjen e kërkuar nga kontrata e qirasë

Aktivitet me të drejtë përdorimi amortizohen me vlerën më të vogël mes jetës së dobishme të aktivitet dhe kohëzgjatjes së kontratës. Nëse ekziston një mundësi e arsyeshme për të blerë aktivin, e drejta e përdorimit të

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Aktive me të drejtë përdorimi (vazhdim)

aktivit amortizohet bazuar në jetën e dobishme. Amortizimi i të drejtës së përdorimit të aktivit llogaritet në bazë lineare bazuar në jetën e dobishme:

	<u>Jeta ekonomike (vite)</u>
Toka*	2-19
Ndërtesa	1-19
Makineri	7-8
Mjete transporti	3
Aktive të tjera	2

**E drejta e përdorimit të tokës do të zhvlerësohet, ndonëse toka në vetvete ka një jetë të dobishme të pakufizuar e drejta e përdorimit të tokës kufizohet nga kushtet e kontratës*

Instrumentet financiare- termat kryesore të matjes

Vlera e drejtë është çmimi që do të merret për të shitur një aktiv ose paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Treguesi më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg aktiv është ai në të cilin transaksionet për aktivin ose detyrimin bëhen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose pasivin individual dhe numrit të instrumenteve të mbajtura nga Shoqëria. Ky është rasti edhe nëse vëllimi normal i tregtisë ditore të tregut nuk është i mjaftueshëm për të absorbuar sasinë e mbajtur dhe për të vendosur urdhër për të shitur pozicionin në një transaksion të vetëm mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknikat e vlerësimit siç janë modelet e skontimit të flukseve të mjeteve monetare ose modele të bazuara në transaksionet e fundit midis palëve të lidhura ose shqyrtimi i të dhënave financiare të të investuarve përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuara financiare për të cilat informacioni i çmimeve të tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e observueshme të tregut (domethënë matja kërkon hyrje të rëndësishme të pakontrollueshme). Transfertat midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë konsiderohen se kanë ndodhur në fund të periudhës raportuese.

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, lëshimit ose shitjes së një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo që nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifatat dhe komisionet që u paguhen agjentëve (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), këshilltarët, agjentët dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë dhe transferimin e taksave dhe detyrimeve. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxheve ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

Kostoja e amortizuar ("KA") është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në njohjen fillestare duke zbritur çdo ripagim kryesor, plus interesin e përlllogaritur dhe për aktivet financiare minus çdo kompensim për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK"). Interesi i përlllogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose zbritje në shumën e maturimit duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e akumuluarat të interesit dhe shpenzimet e interesit të përlllogaritur, duke përfshirë edhe kuponin e akumuluar dhe zbritjen ose shpërblimin e amortizuar (përfshirë tarifatat e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten veças dhe përfshihen në vlerat bartëse të zërave në pasqyrën e pozicionit financiar.

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Metoda e interesit efektiv është një metodë e ndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që zbrit pagesat e ardhshme të parasë ose faturat (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë) nëpërmjet jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar. Norma efektive e interesit zbrit fluksin e mjeteve monetare të instrumenteve me interes të ndryshueshëm deri në datën e ardhshme të interesit, përveç primeve ose zbritjes që pasqyrojnë diferencën e kredisë mbi normën e variueshme të specifikuar në instrument ose variabla të tjerë që nuk rivendosen në normat e tregut. Primit ose zbritjet e tilla amortizohen gjatë tërë jetës së pritshme të instrumentit. Llogaritja e vlerës aktuale përfshin të gjitha pagesat e paguara ose të marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Instrumentet financiare – Njohja fillestare. Instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ekziston një ndryshim midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit i cili mund të dëshmohet nga transaksione të tjera të vëzhguara të tregut aktual në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, inputet e të cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullim ose konventë të tregut ("blerje dhe shitje" në mënyrë të rregullt) regjistrohen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet për të dhënë një aktiv financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur njësia ekonomike bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasme – kategoritë e matjes. Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA (sipas paragrafit më lart). Klasifikimi dhe matja e mëpasme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivitetit.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasme – modeli i biznesit. Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale ("mbajtja për mbledhje e flukseve monetare") ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve ("mbajtja për mbledhje e flukseve monetare dhe shitje") ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit "të tjera" dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare individuale (në nivel individual) bazuar në të gjithë evidencën përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin individual në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxherët. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në përcaktimin e modeleve të biznesit për aktivet e saj financiare.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasme – karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare. Kur modeli i biznesit ka si objektivi mbajtjen e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Aktivet financiare me derivativë të përfshirë konsiderohen në tërësinë e tyre kur përcaktohet nëse flukset monetare të tyre janë në përputhje me tiparin VPPI. Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasme – karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare (vazhdim)

në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për rrezikun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Aktivet financiare – riklasifikimi. Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur modeli i biznesit për menaxhimin e portofolit në tërësi ndryshon. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Shoqëria nuk ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe asaj krahasuese, dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

Zhvlërësi i aktiveve financiare - provizion për humbjen e kredisë nga HPK. Shoqëria vlerëson, bazuar në parashikime, HPK për instrumentet e borxhit të matura në KA dhe VDATGJ dhe për ekspozimet që rrjedhin nga angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, për aktivet e kontratës. Shoqëria mat HPK dhe njeh humbjet neto të zhvlërësimit në aktivet financiare dhe të kontratës në çdo datë raportimi. Matja e HPK pasqyron: (i) një sasi të paanshme dhe të ponderuar të probabilitetit që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, (ii) vlerën kohore të parasë dhe (iii) të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kostot dhe përpjekjet e panevojshme në fund të secilës periudhë raportuese për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme. Humbja e pritshme e kredisë llogaritet duke përdorur metodën e thjeshtuar të zhvlërësimit, duke matur jetëgjatësinë e HPK.

Shoqëria zbaton qasjen e thjeshtuar për të gjitha të arkëtueshmet tregtare dhe aktivet e kontratës në përputhje me SNRF 15 që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi përveç nëse nuk ka pasur dëshmi objektive të zhvlërësimit në njohjen fillestare.

Aktivet financiare dhe ekspozimet e tjera të rrezikut nuk duhet të monitorohen për ndryshimet në rrezikun e kredisë me kalimin e kohës, por kompensimi i humbjeve për këto ekspozime rreziku gjithmonë njihet në datën e raportimit në vlerën aktuale të humbjeve të pritshme përgjatë gjithë jetës (“HPK PGJJ”). Nëse ka evidencë objektive të zhvlërësimit, aktivet financiare transferohen në Fazën 3 si në rastin e qasjes së përgjithshme. Deri në atë datë, të ardhurat nga interesi llogariten mbi bazën e vlerës kontabël neto. Në rastin e një rënieje të rrezikut të kredisë sipas metodës së thjeshtuar, njohja e të ardhurave nga interesi rimendohet në bazë të vlerës kontabël bruto.

Aktivet financiare – fshirja. Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer çdo përpjekje për rimarrjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit. Treguesit që nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mosshlyerjes, paaftësi paguese dhe falimentim. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që janë subjekt i zbatimit me forcë të marrëveshjes kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për marrjen e tyre.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Aktivet financiare - modifikimi. Shoqëria ndonjëherë rinegocion ose modifikon ndryshe kushtet kontraktuale të aktiveve financiare. Shoqëria vlerëson nëse modifikimi i flukseve të mjeteve monetare kontraktuale është i konsiderueshëm duke marrë parasysh, ndër të tjera, faktorët e mëposhtëm: çdo term i ri kontraktual që ndikon ndjeshëm profilin e rrezikut të aktivit, ndryshimin e rëndësishëm në normën e interesit, ndryshimin në denominimin e monedhës, kolateralin e ri ose rritjen e kredisë që ndikon ndjeshëm rrezikun e kredisë që lidhet

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Aktivitetet financiare – modifikimi (vazhdim)

me aktivin ose një zgjatje të konsiderueshme të një huaje kur huamarrësi nuk është në vështirësi financiare.

Nëse kushtet e modifikuara janë në thelb të ndryshme, të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivi origjinal skadojnë dhe Shoqëria çregjistron aktivin financiar fillestar dhe njeh një aktiv të ri me vlerën e tij të drejtë. Data e rinegociimit konsiderohet të jetë data e njohjes fillestare për qëllimet e llogaritjes së zhvlerësimit, duke përfshirë përcaktimin nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë (“RNRK”). Shoqëria gjithashtu vlerëson nëse kredia e re ose instrumenti i borxhit plotëson kriterin e SPPI. Çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të aktivitetit origjinal të çregjistruar dhe vlerës së drejtë të aktivitetit të ri të modifikuar materialisht njihet në të ardhura dhe shpenzime, përveç nëse përmbajtja e diferencës i atribuohet një transaksioni kapital me pronarët.

Në një situatë kur rinegociimi ishte nxitur nga vështirësitë financiare të palës tjetër dhe pamundësia për të bërë pagesat e pranuar fillimisht, Shoqëria krahason flukset monetare të pritshme dhe të rishikuara të parasë me aktivet, nëse rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit janë në thelb të ndryshme si rezultat i modifikimit kontraktual. Nëse rreziqet dhe përfitimet nuk ndryshojnë, aktivi i modifikuar nuk është në thelb i ndryshëm nga aktivi origjinal dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin. Shoqëria rikalkulon vlerën kontabël bruto duke skontuar flukset monetare kontraktuale të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv dhe njeh një fitim ose humbje modifikimi në ardhura dhe shpenzime.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në KA, përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDNFH: ky klasifikim aplikohet për derivativet, detyrimet financiare të mbajtura për shitje (p.sh. pozicionet afatshkurtra me letra me vlerë), shuma e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

Një shkëmbim ndërmjet Shoqërisë dhe huadhënësve të saj të origjinës të instrumenteve të borxhit me kushte shumë të ndryshme, si dhe modifikime thelbësore të termave dhe kushteve të detyrimeve financiare ekzistuese, llogariten si shlyerje e detyrimit financiar fillestar dhe njohja e një detyrimi të ri financiar. Kushtet janë thelbësisht të ndryshme në qoftë se vlera e skontuar e flukseve të mjeteve monetare sipas kushteve të reja, duke përfshirë çdo pagesë të paguar neto nga çdo tarifë e marrë dhe zbritur duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10% ndryshe nga vlera aktuale e skontuar e flukset monetare të mbetura të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikimi i kushteve llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar njihet si pjesë e fitimit ose humbjes në shlyerje. Nëse shkëmbimi ose modifikimi nuk llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar rregullon vlerën kontabël të pasivit dhe amortizohet gjatë afatit të mbetur të detyrimit të modifikuar.

Ndryshimet e detyrimeve që nuk rezultojnë në shlyerje llogariten si një ndryshim në vlerësim duke përdorur një metodë kumulative mbledhjeje, me çfarëdo fitimi ose humbjeje të njohur në ardhura dhe shpenzime, përveç nëse përmbajtja ekonomike e diferencës në vlerat bartëse i atribuohet kapitalit transaksion me pronarët.

Kompesimi i instrumenteve financiare. Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë netimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagese dhe (iii) në rast të paftësisë paguese ose falimentimit.

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në KA sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre (vazhdim)

të mjeteve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare kontraktuale reflektojnë VPPI (ii) dhe nuk janë të dizenuara me VDNFH.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera . Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj të performancës sipas kontratës dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas mbahet me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë. Huatë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur kostot e transaksionit dhe më pas mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Garancitë financiare. Garancitë financiare janë kontrata të parevokueshme që kërkojnë nga Shoqëria që të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka për shkak se një debitor i specifikuar nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Garancitë financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuar. Kjo shumë amortizohet në bazë të vijës së drejtë gjatë jetës së garancisë. Në fund të secilës periudhë raportuese, garancitë maten më të larta se (i) shuma e lejueshme e humbjes për ekspozimin e garantuar të përcaktuar bazuar në modelin e pritur të humbjes dhe (ii) bilanci i mbetur i paamortizuar i shumëve në njohjen fillestare.

Detyrime për qiranë. Detyrimet për qiranë maten në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse monetare. Detyrimet për qiranë përfshijnë vlerën aktuale të pagesave të mëposhtme:

- pagesa fikse, të pakësuara nga çdo stimul qiraje të marrë,

Mundesitë e shtyrjes dhe përfundimit janë të përfshira në një numër të konsiderueshëm të qirave për aktivet e Shoqërisë. Këto kushte përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në menaxhimin e aseteve që Shoqëria përdor për operacionet e saj. Pjesa më e madhe e opsioneve të shtyrjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga ana e Shoqërisë dhe jo nga qiradhënësi. Opsionet e shtyrjes janë përfshirë në periudhën e qirasë nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e mundur për tu shtyrë (ose për mos u përfunduar). Pagesat e qirasë që i përkasin periudhës së shtyrjes janë të përfshira në llogaritjen e detyrimit për qiranë financiare.

Pagesat për qiranë janë të aktualizuara duke përdorur normën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, që është dhe rasti i qirave të Shoqërisë, përdoret norma e huamarrjes e cila është norma me të cilën Shoqëria do të duhej të merrte hua fonde për të blerë aktive me vlerë sa vlera e aktivitetit me të drejtë përdorimi në një mjedis ekonomik të ngjashëm dhe me kushte apo kolateral të ngjashëm.

Për të përcaktuar normën e huamarrjes Shoqëria:

- përdor një normë interesi pa rrezik, e ndryshuar duke marrë parasysh rrezikun e kreditit
- bën ndryshime specifike në lidhje me qiranë, për shembull termat, vendin, monedhën dhe kolateralin

Shoqëria është e ekspozuar ndaj një rritje të mundshme në të ardhmen të pagesave të ndryshueshme të qirasë të bazuara në një indeks apo normë, të cilat nuk janë të përfshira në detyrimin për qiranë derisa të hyjnë në fuqi. Kur pagesat e ndryshueshme të qirasë të bazuara në një indeks apo normë hyjnë në fuqi, detyrimi për qiranë rillogaritet dhe ndryshohet kundrejt aktivitetit me të drejtë përdorimi.

Pagesat e qirasë ndahen mes principalit dhe kostos financiare. Kostot financiare njihen në fitim ose humbje përgjatë kohëzgjatjes së qirasë për të rezultuar në një normë interesi konstante dhe periodike për balancën e mbetur të detyrimit për çdo periudhë.

American Hospital SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Detyrime për qiranë (vazhdim)

Pagesat e qirasë afatshkurtër të pajisjeve dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazën e metodës lineare si shpenzim në fitim ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qira me kohëzgjatje prej 12 muajsh ose më pak. Aktivet me vlerë të ulët janë pajisje mjekësore që e kanë vlerën më të ulët se 1,500 Euro ose më pak.

Për të optimizuar kostot e qirasë gjatë periudhës së kontratës, Shoqëria ndonjëherë jep garanci në bazë të vlerës së mbetur për qiradhëniet e pajisjeve. Shoqëria fillimisht vlerëson dhe njeh shumat që pritet të paguhet nën garancitë e vlerës së mbetur si pjesë e detyrimit të qirasë. Zakonisht, vlera e mbetur e pritshme në fillimin e qirasë është e barabartë me ose më e lartë se shumata e garantuar, kështu që Shoqëria nuk pret që të paguajë asgjë sipas garancive.

Në fund të çdo periudhe raportimi, vlerat e pritshme të mbetura rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, për të pasqyruar vlerat aktuale të mbetura të arritura në aktive të ngjashme dhe pritshmëritë për çmimet në të ardhmen.

Qeraja operative.

Kur Shoqëria është qiradhënës në një qira e cila nuk transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi, pagesat e qirasë njihen si të ardhura të tjera në bazë lineare.

Taksa mbi fitimin

Tatimi në të ardhurat aktuale llogaritet në bazë të rregullave të tatimit mbi të ardhurat që zbatohen në Shqipëri, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit. Ngarkesa e tatimit mbi të ardhurat përbën tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në të ardhura dhe shpenzime për vitin, përveç nëse kjo është njohur në kapitalin neto ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose direkt në kapital.

Tatimi aktual është shumata që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat e tanishme dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet nëse pasqyrat financiare janë të autorizuar përpara se të dorëzojnë deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet përveç të ardhurave regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave sigurohet duke përdorur metodën e detyrimit të bilancit për humbjet tatimore që mbartin përpara dhe diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një detyrimi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon në asnjë llogari, as fitim të tatueshëm. Bilancet tatimore të shtyra maten me normat e tatimit të miratuara ose të vendosura në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, bartjen e mjeteve tatimore të papërdorura dhe humbjet tatimore të papërdorura, deri në masën që është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme, dhe humbjet e papërdorura tatimore mund të përdoren.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompesohen kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e aktiveve tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ka një qëllim për të shlyer gjendjet në bazë neto.

American Hospital SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Situata të pasigurta tatimore. Situatat e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishqyrtohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozitat do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose miratuar në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo gjykatë të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për ndëshkimet, interesat dhe tatimet tjera nga të ardhurat njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, përveç interesit dhe gjobave, regjistrohen brenda tatimit mbi të ardhurat. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat në lidhje me interesin dhe gjobat regjistrohen brenda shpenzimeve financiare dhe fitimeve / (humbjeve) të tjera, neto, përkatësisht.

Inventari. Inventarët maten me çmimin më të ulët dhe me vlerën neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën specifike të identifikimit dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kostot e tjera të shkaktuara në sjelljen e inventarëve në vendin dhe gjendjen e tyre aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimeve të shitjes.

Parapagimet

Parapagimet mbahen me kosto minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që vetë klasifikohet si jo aktuale pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivit sapo Shoqëria merr kontrollin e aktivit dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin do të rrjedhin në Kompani. Pagesat paraprake të tjera shënohen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një indikacion se aktivet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të pranohen, vlera bartëse e parapagimit shënohet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse e zhvlerësimit njihet në të ardhura dhe shpenzime për vitin.

Kapitali Aksionar

Aksionet e zakonshme janë të klasifikuara si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, neto nga tatimi, nga të ardhurat. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si pronë e aksioneve në kapitalin neto.

Provizionet

Provizionet për detyrimet janë detyrime jo financiare me kohë ose shuma të pasigurta. Ato janë përlllogaritur kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Rezervat maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohet për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provizion për shkak të kalimit të kohës njihet si një shpenzim i interesit.

Taksat dhe tarifatat, të tilla si tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat ose tarifatat rregullatore të bazuara në informacionet që lidhen me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja obliguese që shkakton pagesën e taksës, siç përcaktohet nga legjislacioni që shkakton detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

American Hospital SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat i përkasin aktiviteteve të zakonshme të Shoqërisë. Të ardhurat njihen në shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret t'i përkasi në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumat e mbledhura në emër të palëve të treta. Të ardhurat njihen neto nga zbritjet.

Shitjet nga shërbimet mjekësore. Shoqëria ofron shërbime me kontrata fikse. Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet ofrohen. Për kontratat me çmim fikse, të ardhurat njihen në bazë të shërbimit aktual të ofruar deri në fund të periudhës raportuese si një pjesë e totalit të shërbimeve që duhet të ofrohen, sepse klienti i merr dhe i përdor përfitimet njëkohësisht. Kjo përcaktohet bazuar në orët aktuale të punës të shpenzuara në krahasim me orët e përgjithshme të punës të pritshme. Kur kontratat përfshijnë detyrime të shumëfishta të performancës, çmimi i transaksionit ndahet për secilën detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet shitëse të pavarura. Kur ato nuk janë drejtpërdrejtë të vëzhgueshme, ato vlerësohen bazuar në koston e pritshme plus marzhin.

Përlllogaritjet e të ardhurave, kostove ose shtrirjes së progresit drejt përfundimit rishikohen nëse rrethanat ndryshojnë. Çdo rritje ose zvogëlim i të ardhurave ose shpenzimeve të llogaritura reflektohet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën rrethanat që sjellin rishikimin bëhen të njohura nga drejtimi. Nëse kontrata përfshin shumën e ndryshueshme, të ardhurat njihen vetëm në atë masë që është shumë e mundshme që nuk do të ketë ndryshim të konsiderueshëm.

Shitjet e produkteve të shëndetit dhe farmaceutike. Shitjet njihen kur kontrolli i mallit është transferuar, kur mallrat janë dorëzuar tek klienti, konsumatori ka liri të plotë mbi mallrat dhe nuk ka detyrim të paplotësuar që mund të ndikojë në pranimin e mallrave të klientit. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë vënë në dispozicion të klientit, rreziqet e vjetërsisë dhe humbjes janë transferuar tek klienti dhe konsumatori ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën, dispozitat e pranimit janë anuluar ose Shoqëria ka dëshmi objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbushur.

Të ardhurat nga shitjet me zbritje njihen në bazë të çmimit të specifikuar në kontratë, netim nga zbritjet e llogaritura. Përvoja e akumuluar përdoret për të vlerësuar dhe siguruar zbritjet, duke përdorur metodën e vlerës së pritshme dhe të ardhurat njihen vetëm në atë masë që është shumë e mundshme që një ndryshim i rëndësishëm nuk do të ndodhë. Një detyrim rimbursimi (i përfshirë në tregtinë dhe detyrimet e tjera) njihet për uljet e pritshme të vëllimit të pagueshëm për klientët në lidhje me shitjet e bëra deri në fund të periudhës raportuese. Një arkëtim njihet kur mallrat dorëzohen pasi që kjo është pika në kohë që shqyrtimi është i pakushtëzuar, sepse kërkohet vetëm kalimi i kohës përpara se të bëhet pagesa.

Të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi regjistrohen për të gjitha instrumentet e borxhit në bazë aktuale duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kjo metodë shlyen, si pjesë e të ardhurave nga interesi, të gjitha tarifat e marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv, të gjitha primet e tjera ose zbritjet.

Tarifat integrale me normën efektive të interesit përfshijnë tarifat e origjinës të marra ose të paguara nga Shoqëria lidhur me krijimin ose blerjen e një aktivi financiar, për shembull tarifat për vlerësimin e aftësisë kreditore, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimin e kushteve të instrumentit dhe për përpunimin dokumentet e transaksionit.

Për aktivet financiare të krijuara ose të blera me kredi të zhvlerësuar, norma efektive e interesit është norma që zbret flukset monetare të pritshme (përfshirë humbjet fillestare të pritshme të kredisë) në vlerën e drejtë në njohjen fillestare (normalisht përfaqësohet nga çmimi i blerjes). Si rezultat, interesi efektiv është i rregulluar nga kredia.

Të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare, përveç (i) aktiveve financiare që kanë pësuar rënie të kredisë (Faza 3), për të cilat llogaritet të ardhurat nga interesi duke zbatuar normën efektive të interesit të tyre AC, neto nga provizioni HPK dhe (ii) aktivet financiare që janë blerë ose kanë origjinën nga kreditë e dëmtuara, për të cilat norma e interesit efektiv të rregulluar nga kredia është aplikuar për KA.

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Përfitimet e punonjësve

Pagat, kontributet në fondet e pensioneve shtetërore dhe ato të sigurimeve shoqërore, lejet vjetore dhe pushimet mjekësore, shpërblimet dhe përfitimet jo monetare (siç janë shërbimet shëndetësore) grumbullohen në vitin në të cilin shërbimet e lidhura jepen nga punonjësit e Shoqërisë. Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të bërë pagesa të pensioneve ose përfitimeve të ngjashme përtej pagesave në skemën statutores të kontributeve të përcaktuara.

3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në rrethanat. Drejtimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Vendimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Parimi i vijimësisë

Drejtimi do të përgatisë pasqyrat financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Për të bërë këtë, drejtimi konsideroi pozicionin financiar të Shoqërisë, fitimin nga operacionet, planet e biznesit dhe burimet financiare, dhe analizoi ndikimin e zhvillimeve makroekonomike në operacionet e Shoqërisë, përfshirë ngjarjet pas datës së raportimit (Shënimi 30).

Shoqëria ka pësuar një humbje neto prej 53,462 mijë Lekë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 (2018: Lekë 167,782 mijë) humbje nga aktiviteti operativ prej 14,317 mijë Lekë (2018: 203,480 mijë Lekë). Detyrimet e saj afatshkurtra tejkalojnë aktivet e saj afatshkurtra me 1,224,439 mijë Lekë në 31 dhjetor 2019 (2018: tejkaluar me 1,003,930 mijë Lekë).

Shoqëria vazhdoi të gjenerojë flukse hyrëse parash nga aktivitetet e saj operative në vitin 2019 dhe pret që të vazhdojë ta bëjë këtë edhe në të ardhmen.

Pas ndikimit të ndjeshëm negativ të pandemisë COVID-19 në shkallën e operacioneve të Shoqërisë, drejtimi ra dakord për shtyrjen e ripagimit të borxhit me huamarrësit e saj dhe zbatoi një plan për të kontrolluar kostot dhe për të arritur një rezultat të qëndrueshëm operativ përgjatë vitit. Shoqëria ka pezulluar të gjitha investimet kapitale dhe shpenzimet operative jo-thelbësore për të ruajtur likuiditetin, ka marrë nga bankat e saj miratimin për të rritur kufijtë e kapitalit qarkullues me një shtesë prej 2.5 milion EUR (304 milion Lekë) mbi kufinj të ekzistues në nivel Grupi.

Bazuar në planet e azhuruara për vitin që pasqyrojnë shpërthimin e COVID-19, pritshmëritë e reja në lidhje me të ardhurat, rezultatet e operimit, flukset e parave, mbështetjen e marrë nga ofruesit vendor dhe ndërkombëtarë të kredisë dhe besimin dhe angazhimin e financuesve të tjerë, drejtimi i Shoqërisë beson se është e përshtatshme të përgatiten këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë.

Zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe arkëtueshmeve të tjera. Shoqëria zbaton metodën e thjeshtuar të SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritshme të kredisë që përdor një humbje të pritshme për të gjitha të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera. Për të matur humbjet e pritshme të kredisë, Të arkëtueshmet tragëtare dhe të arkëtueshmet e tjera janë grupuar në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut të kredisë dhe ditëve të kaluara. Normat e pritshme të humbjeve bazohen në profilet e pagesave të shitjeve gjatë një periudhe kohore dhe humbjet historike përkatëse të kreditit që kanë ndodhur brenda kësaj periudhe. Normat historike të humbjeve janë përshtatur për të pasqyruar informacionin aktual dhe të ardhshëm të faktorëve makroekonomikë që ndikojnë në aftësinë e klientëve për të shlyer llogaritë e arkëtueshme. Zbritja e humbjes së kredisë për tregtinë dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme përcaktohet sipas matricës së provizionit, normat e humbjeve dhe HPK-të për fundin e vitit 2019 janë paraqitur në tabelën më poshtë

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Zhvlërësimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe arkëtueshmeve të tjera (vazhdim)

Matrica e provizioneve bazohet në numrin e ditëve që një aktiv është i kaluar, efekti i informacionit të ardhshëm është konsideruar si i parëndësishëm.

Ditët e kaluara	31 dhjetor 2019		Vlera kontabël bruto	Kohëzgjatja HPK
	Humbje në % Individ	Humbje në % Shoqëri		
0 – 30 Ditë	21.55%	1.88%	43,432	3,082
31-60 Ditë	37.47%	1.29%	15,152	1,796
61-90 Ditë	29.91%	5.00%	21,180	1,811
91-180 Ditë	43.20%	21.92%	25,278	7,362
181-360 Ditë	54.88%	51.21%	18,296	9,821
Mbi 360 Ditë	100.00%	100.00%	12,845	12,845
Totali			136,184	36,719

Jeta e dobishme e pajisjeve. Vlerësimi i jetës së dobishme të pajisjeve është çështje e gjykit bazuar në aktive të ngjashme. Përfitimet ekonomike të ardhshme në aktivet konsumohen kryesisht përmes përdorimit. Megjithatë, faktorë të tjerë, siç janë vjetërsia teknike dhe komerciale dhe konsumimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të mishëruara në asete.

Drejtimi vlerëson jetët e dobishme të mbetura në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës pritet që asetet të fitojnë përfitime për kompaninë. Konsiderohen faktorët kryesorë në vijim:

- përdorimi i pritshëm i aktiveve;
- konsumimi fizik i pritshëm, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe
- teknike ose komerciale që rrjedhin nga ndryshimet në kushtet e tregut.

Nëse jetët e dobishme të vlerësuara do të ndryshonin me 10% nga vlerësimet e drejtimin, ndikimi në zhvlërësim për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019 do të ishte rritje me 28,474 mijë lekë ose zvogëlim me 25,956 mijë lekë (2018: rritje me 27,320 mijë lekë ose ulje me 24,058 mijë leke).

Zhvlërësimi i aktiveve me të drejtë përdorimi. Në përcaktimin e kohëzgjatjes së qirasë, Drejtimi konsideron të gjithë faktorët dhe rrethanat të cilat mund të nxisin ushtrimin e opsionit të shtyrjes apo përfundimit. Opsioni i shtyrjes përfshihet në periudhën e qirasë vetëm atëherë kur ekziston një siguri në shtyrjen (ose mos përfundimin) e qirasë.

Për qiradhëniet zyrate, pajisjeve dhe mjeteve të transportit faktorët e mëposhtëm janë zakonisht më të rëndësishmit:

- Nëse nuk ka penalitete të konsiderueshme për përfundimin e qirasë, Shoqëria është zakonisht e sigurt për të shtyrë (mos përfunduar) qiranë.
- Nëse përmirësimet e ndërtesës pritet të kenë një vlerë të rëndësishme të mbetur, Shoqëria është zakonisht e sigurt për shtyrjen (mos përfundimin) e qirasë

Gjithashtu, Shoqëria, konsideron faktorë të tjerë duke përfshirë kohëzgjatjen historike të qirasë dhe koston e ndërprerjes së biznesit të kërkuar për zëvendësimin e aktivitetit. Pjesa më e madhe e opsioneve për qiratë e zyrate dhe mjeteve të transportit nuk janë përfshirë në detyrimin e qirasë sepse Shoqëria mund ti zëvendësojë pa kosto të rëndësishme apo ndërprerje të biznesit.

Opsioni i shtyrjes dhe përfundimit. Opsionet e shtyrjes dhe përfundimit janë të përfshirë në një numër të konsiderueshëm të qirave. Ato përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në terma të menaxhimit të aktiveve të përdorura gjatë aktivitetëve të ndryshme. Shumica e opsioneve të zgjatjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga Shoqëria dhe jo nga qiradhënësi përkatës.

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Opsioni i shtyrjes dhe përfundimit (vazhdim)

Në përcaktimin e kohëzgjatjes së qirasë, Drejtimi konsideron të gjithë faktorët dhe rrethanat të cilat mund të nxisin ushtrimin e opsionit të shtyrjes apo përfundimit. Opsioni i shtyrjes përfshihet në periudhën e qirasë vetëm atëherë kur ekziston një siguri në shtyrjen (ose mos përfundimin) e qirasë.

Për qiradhëniet e ndërtesave dhe pajisjeve, faktorët e mëposhtëm janë zakonisht më të rëndësishmit:

- Nëse nuk ka penalitete të konsiderueshme për përfundimin e qirasë, Shoqëria është zakonisht e sigurt për të shtyrë (mos përfunduar) qiranë.
- Nëse përmirësimet e ndërtesës pritet të kenë një vlerë të rëndësishme të mbetur, Shoqëria është zakonisht e sigurt për shtyrjen (mos përfundimin) e qirasë
- Gjithashtu, Shoqëria, konsideron faktorë të tjere duke përfshirë kohëzgjatjen historike të qirasë dhe koston e ndërprerjes së biznesit të kerkuar për zëvendësimin e aktivitetit.

Pjesa më e madhe e opsioneve për qiratë e zyrave dhe mjeteve të transportit nuk janë përfshirë në detyrimin e qirasë sepse Shoqëria mund ti zëvendësojë pa kosto të rëndësishme apo ndërprerje të biznesit.

Me 31 dhjetor 2019, flukse të ardhshme të mundshme të parasë prej 183 mijë lekë (jo të aktualizuara) nuk janë përfshirë në detyrimin e qirasë, sepse nuk është e sigurt që qiratë do të zgjaten (ose jo të përfundojnë).

Afati i qirasë rishikohet nëse një opsion është ushtruar (ose nuk ushtrohet) ose kompania bëhet e detyruar të ushtrojë (ose jo ta ushtrojë) atë. Vlerësimi i sigurt dhe i arsyeshëm rishikohet vetëm nëse ndodh një ngjarje e rëndësishme ose një ndryshim i rëndësishëm i rrethanave, gjë që ndikon në këtë vlerësim, dhe që është nën kontrollin e qiramarrësit.

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektiv për periudhën raportuese duke filluar nga 1 janar 2019). Shoqëria adoptoi SNRF 16 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive të adoptimit me datën e aplikimit fillestar të 1 Janarit 2019. Sipas kësaj metode, standardi aplikohet në mënyrë retrospektive me efektin kumulativ të aplikimit fillestar të njohur në bilancin e çeljes më 1 Janar 2019.. Aktivitetet me të drejtë përdorimit për ndërtesat janë llogaritur sikur rregullat e reja të ishin të aplikueshme që më parë. E drejta e përdorimit për aktivitetet e tjera është llogaritur bazuar në shumën e detyrimit (e ndryshuar për shpenzimet e parapaguara apo të shtyra).

Në aplikimin e SNRF 16 për herë të parë, Shoqëria ka përdorur mjetet e mëposhtme praktike në tranzicion të lejuara nga standarti:

- duke aplikuar një normë të vetme zbritje në një portofol të qirave me karakteristika të arsyeshme të ngjashme,
- për kontratat e lidhura para datës së tranzicionit, duke u mbështetur në vlerësimin e tij të bërë duke aplikuar SNK 17 dhe Interpretimin 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira,
- llogaritjen e qirave operative me një afat të mbetur qiraje më pak se 12 muaj nga 1 Janari 2019 si qira afatshkurtra,
- duke përjashtuar kostot fillestare direkte për matjen e aktivitetit të së drejtës së përdorimit në datën e aplikimit fillestar, dhe,
- duke përdorur mbikëqyrje në përcaktimin e afatit të qirasë, kur kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Shoqëria ka zgjedhur të mos ripërcaktojë nëse një kontratë është apo përmban një qira në datën fillestare të aplikimit. Për kontratat e hyra në fuqi para datës së aplikimit Shoqëria është bazuar në përcaktimin e parashikuar duke aplikuar SNK 17, Qiratë, and KIRFN 4, *Të përcaktosh nëse një kontratë përmban Qira.*

Norma e skontimit e aplikuar nga Shoqëria në detyrimet e qirasë është në 1 janar 2019 ishte 4.96%.

Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte detyrime qiraje të pa-anullueshme prej 817,910 mijë lekë. Nga këto angazhime, 20,296 mijë lekë janë të lidhura me qira afatshkurtra dhe 165 mijë Lekë me qira me vlerë të vogël, të dyja të njohura mbi baza lineare si një shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Një rakordim i angazhimeve të qirasë operative me detyrimin e njohur, është si më poshtë:

	31 dhjetor 2018 / 1 janar 2019
Pagesat minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të paanullueshme më 31 dhjetor 2018	817,810
- Pagesa të ardhshme të qirasë që janë rezultat i një trajtimi të ndryshëm të opsioneve të përfundimit dhe shlyerjes	56,467
- Efekti i aktualizimit	(223,674)
- Qira afatshkurtër e panjohur si detyrim	(20,296)
- Qira për aktive me vlerë të vogël e panjohur si detyrim	(165)
Totali i detyrimeve të qirasë më 1 janar 2019	630,142
<hr/>	
Nga të cilat janë:	
Detyrime afatshkurtra për qira	-
Detyrime afatgjata për qira	630,142

American Hospital SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

*(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)***4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)**

Ndryshimi ne standartin kontabël ndikoi elementët e mëposhtëm në pasqyrën e pozicionit financiar më 1 janar 2019:

<i>Në mijë Lek</i>	Aplikimi I SNRF 16
Ulje në aktivet afatgjatë	-
Rritje e aktiveve me të drejtë përdorimi	622,969
Rritje në detyrimet e qirasë	630,142
Rritje/(rënie) në kapital – fitim i pashpërndarë, neto nga tatami i shtyrë	-
Rritje në aktive afatgjata të mbajtura për investim	7,173

Standartet e mëposhtme u bene efektive më 1 janar 2019 por nuk patën ndonje efekt material në Shoqërinë:

- Ndryshimet në SNK 19 "Plani i ndryshimit, ndalimit ose zgjidhjes" (publikuar në 7 shkurt 2018 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkët" (publikuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).
- Përmirësime Vjetore të Ciklit të SNRF 2015-2017 - ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (publikuar në 12 Dhjetor 2017 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (publikuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).
- KIRNF 23 "Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat" (publikuar në 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).

American Hospital SH.A.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

5. Standarde dhe interpretime të reja

Disa standarde dhe interpretime janë publikuar dhe janë të detyrueshme për periudhën prej 1 janar 2020, por që Shoqëria nuk i ka aplikuar më herët.

- Ndryshime në Kornizën Konceptuale për Raportimin Financiar (publikuar më 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2020). Kuadri Konceptual i rishikuar përfshin një kapitull të ri për matjen; udhëzime për raportimin e performancës financiare; përkufizime dhe udhëzime të përmirësuara - veçanërisht përcaktimi i një detyrimi; dhe sqarime në fusha të rëndësishme, të tilla si rolet e administrimit, maturisë dhe pasigurisë së matjes në raportimin financiar.
- Shitja ose Kontributi i Aseteve midis një Investitori dhe Ndërmarrjes së Përbashkët të Tij - Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar në 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohen nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2021).
- Përkufizimi i një biznesi - Ndryshime në SNRF 3 (publikuar në 22 tetor 2018 dhe efektive për blerjet nga fillimi i periudhës vjetore të raportimit që fillon në ose pas 1 Janarit 2020).
- Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar në 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2020).
- Reforma e normës së interesit - Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 (publikuar në 26 shtator 2019 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2020).

Nëse nuk përshkruhet ndryshe më lart, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

American Hospital SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

*(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)***6. Aktive afatgjata materiale**

	Toka	Ndërtesa dhe përmirësimt	Makineri dhe Pajisje	Automjete	Mobilje dhe pajisje elektronike	Aktive në proces	Totali
<i>Kosto</i>							
Më 1 janar 2018	98,704	1,416,674	1,776,304	30,121	247,821	139,424	3,709,048
Shtesa	-	254,450	361,486	26,380	35,151	(59,224)	618,243
Shitje dhe pakësime	-	(702)	(124,176)	-	(14,376)	-	(139,254)
Më 31 dhjetor 2018	98,704	1,670,422	2,013,614	56,501	268,596	80,200	4,188,037
Shtesa	-	109,867	277,158	11,658	33,402	(50,966)	381,119
Zhvlerësim i njohur në fiitm ose humbje	-	(26,459)	-	-	-	-	(26,459)
Rivlerësimi	1,869	-	-	-	-	-	1,869
Shitje dhe pakësime	-	(621)	(101,497)	(2,139)	(17,093)	-	(121,350)
Më 31 dhjetor 2019	100,573	1,753,209	2,189,275	66,020	284,905	29,234	4,423,216
<i>Zhvlerësim i Akumuluar</i>							
Më 1 janar 2018	-	(453,969)	(1,115,607)	(18,327)	(124,148)	-	(1,712,051)
Shpenzimi për vitin	-	(82,156)	(156,402)	(4,251)	(30,522)	-	(273,331)
Shitje dhe pakësime	-	291	104,519	-	13,224	-	118,034
Më 31 dhjetor 2018	-	(535,834)	(1,167,490)	(22,578)	(141,446)	-	(1,867,348)
Shpenzimi për vitin	-	(87,941)	(182,728)	(7,487)	(31,421)	-	(309,577)
Shitje dhe pakësime	-	302	75,412	1,846	15,295	-	92,855
Më 31 dhjetor 2019	-	(623,473)	(1,274,806)	(28,219)	(157,572)	-	(2,084,070)
<i>Vlera kontabël e mbetur</i>							
Më 31 dhjetor 2018	98,704	1,134,588	846,124	33,923	127,150	80,200	2,320,689
Më 31 dhjetor 2019	100,573	1,129,736	914,469	37,801	127,333	29,234	2,339,146

Toka dhe ndërtesat janë rivlerësuar në vlerën e tregut më 31 dhjetor 2019. Vlerësimi u krye nga një firmë e pavarur vlerësuesish, STUDIO LOAD SHPK, të cilët mbajnë një kualifikim profesional të njohur dhe përkatës dhe që kanë eksperiencë në vlerësimin e pasurive të lokacioneve dhe kategorive të ngjashme.

Të përfshira në vlerën kontabël më lart janë 1,869 mijë Lekë që përfaqësojnë një tepëriçë rivlerësimi në lidhje me ndërtesat dhe një humbje nga zhvlerësimi në vlerën 26,460 Lekë në lidhje me tokën e Shoqërisë. Më 31 dhjetor 2019, vlera kontabël e tokës do të ishte 98,704 mijë Lekë (2018: 98.704 mijë Lekë) nëse toka do të njihej me kosto historike. Vlera kontabël e ndërtesave do të ishte 611,250 mijë Lekë (2018: 644,435 mijë Lekë) nëse ndërtesat do të njiheshin me kosto të amortizuar.

Më 31 dhjetor 2019 aktivet afatgjata materiale me vlerë kontabël prej 1,838,004 mijë Lekë (2018: 1,739,864 mijë Lekë) ishin lënë si kolateral për huatë.

American Hospital SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

(të gjithë shumat në mijë LEKË, përveç rasteve kur është e specifikuar ndryshe)

7. Aktive afatgjata të mbajtura për investim

	Aktive afatgjata të mbajtura për investim
Gjendja më 01 janar 2019	410
Shtesa	6,763
Zhvlerësim	(356)
Më 31 dhjetor 2019	6,817

Të ardhurat nga qiraja e aktiveve afatgjata të mbajtura për investim janë 3,836 mijë Lekë (2018: ALL 1,570 mijë Lekë).

8. Aktive me të drejtë përdorimi

	Tokë	Ndërtesa	Pajisje	Automjete	Aktive të tjera	Totali
<i>Kosto</i>						
Vlera kontabël më 1 janar 2019	156,322	418,317	41,152	3,500	3,678	622,969
Shtesat		78,971	-	1,134	-	80,105
Shitje dhe pakësime	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	156,322	497,288	41,152	4,634	3,678	703,074
<i>Zhvlerësim i Akumuluar</i>						
Vlera kontabël më 1 janar 2019	-	-	-	-	-	-
Shpenzimi për vitin	(17,696)	(44,067)	(5,176)	(2,408)	(2,006)	(71,353)
Shitje dhe pakësime	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	(17,696)	(44,067)	(5,176)	(2,408)	(2,006)	(71,353)
<i>Vlera kontabël</i>						
Më 31 dhjetor 2018	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	138,626	453,221	35,976	2,226	1,672	631,721

Shoqëria ka njohur detyrimet e qirasë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	1 janar 2019
Detyrime afatshkurtra për qira	2,167	-
Detyrime afatgjata për qira	642,243	630,142
Totali i detyrimeve të qirasë	644,410	630,142

Shpenzimet e interesit të përfshira në shpenzimet financiare për vitin 2019 janë 32,438 mijë Lekë.

Disa qira të pronave përmbajnë kushte të ndryshueshme pagese që janë të lidhura me shitjet. Kushtet e ndryshueshme të pagesës përdoren për një sërë arsyesh, duke përfshirë minimizimin e kostove bazë fikse. Pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga shitjet njihen në fitimin ose humbjen e periudhës në të cilën shfaqet gjendja që shkakton ato pagesa. Një rritje prej 10% e shitjeve në të gjitha pronat në kompani me kontrata të tilla të qirasë së ndryshueshme do të rrisë pagesa totale të qirasë me afërsisht 19,000 mijë lekë.

Shpenzimet që lidhen me pagesat e ndryshueshme të qirasë të cilat nuk përfshihen në detyrimet e qirasë nën shpenzimet administrative gjatë vitit 2019 ishin 149,592 mijë Lekë. Një prej pronave të marrë me qira përmban kushte të ndryshueshme pagese që lidhen me shitjet e gjeneruara të një prej spitaleve.

American Hospital SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

*(të gjithë shumat në mijë LEKË, përvec rasteve kur është e specifikuar ndryshe)***8. Aktive me të drejtë përdorimi (vazhdim)**

Shpenzimet që lidhen me qiratë afatshkurtra të përfshira në shpenzimet administrative dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët që nuk njihen si qira afatshkurtra të përfshira në shpenzimet administrative:

	2019
Shpenzimet që lidhen me qiratë afatshkurtra	20,846
Shpenzimet që lidhen me qiratë e aktiveve me vlerë të ulët që nuk njihen më lart si qira afatshkurtra	145

Totali i flukseve dalëse të parave për qira në vitin 2019 është 88,506 mijë Lekë.

9. Aktive afatgjata jo materiale

	Programe kompjuterike
<i>Kosto</i>	
